



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2021:019251

Datë: 22.03.2021

Numri i dokumentit: 01617306

P.nr.19/2021

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, gjyqtari Sadri Krasniqi, me sekretaren juridike Tevide Thaqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.A. nga, për shkak të veprës penale: Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit nga neni 294, parag.2, lidhur me nën parag.1 të KPRK-së, të cilin e mbron me autorizim av. L. C., duke vendosur sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani, PP.II.nr.99/2021, të dt. 26.01.2021, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë të datës 26.01.201, në prani të Prokurores së Shtetit Bahtie Ademi, të akuzuarit A.A. dhe mbrojtësin e tij avokat L.C., më 03.03.2021 shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërsa më datën 22.03.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I a k u z u a r i :

A.A., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati V., dhe e ëma M., me mbiemër të vajzërisë R., i lindur më dt., në, jeton në", me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, sipas deklaratës së tij i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër për vepër tjetër penale.

Është fajtor

Sepse:

Me dt. 28.12.2020, në ora 00:20 në lagjen "Malësia", rruga "Wudro Wilson", në Kamenicë, i pandehuri A.A. me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo tjetrin, ka organizuar lojëra të fatit, në atë mënyrë që i njëjti fillimisht merr me qira shtëpinë e H.M. dhe në katin e parë të kësaj shtëpie vendos karriget dhe tavolinën për zhvillimin e lojës së

bixhozit, dhe pas hetimit dhe kontrollit nga policia, aty është gjetur i pandehuri A.A. me 7 persona të tjerë të ulur në karrige rreth tavolinës, secili nga ta kishte letra para vetes, ndërsa në tavolinë janë gjetur një fletore për mbajtjen e evidencës dhe zhetonë për zhvillimin e lojës së pokerit, lojëra të cilat janë organizuar nga vet i pandehuri A.A., me ç`rast janë sekuestruar 595 zhetonë, sënduku i metaltë për vendosjen e zhetonëve, një komplet letra për lojë, një fletore për mbajtjen e evidencës me kopërtina të forta format A4, ndërsa i pandehuri është shoqëruar në polici ku edhe ka pranuar se i njëjti është organizator i kësaj loje të fatit, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta të kundërligjshme, ka organizuar dhe zhvilluar veprimtari të cilat me ligj janë të ndaluara.

-me çka ka kryer veprën penale: Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit nga neni 294, parag.2, lidhur me nën parag.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 38, 42, 44, 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, lidhur me nenin 233, 365 dhe 453 të KPPRK-së, të akuzuarin A.A. e,

G J Y K O N

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej **160 ditëve**, i cili dënim në bazë të nenit 44, parag.1 dhe 2 i KPRK-së, dhe me pëlqimin e të akuzuarit do t`i zëvendësohet në dënim me gjobë, në shumën prej **1.200.00 €**, të cilin dënim me gjobë, i pandehuri obligohet që të e paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit në tri këste mujore, në të kundërtën dënimi me gjobë të njëjtit do ti zëvendësohet me dënim burgu ashtu që për çdo 20 €, do ti llogaritet nga një ditë burg.

Të pandehurit në pajtim me nenin 115, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KPPRK-ës, i konfiskohen: Dy çelësa të aparateve për lojëra të fatit, dy aparate të lojërave të fatit të tipit “Mercur” një aparat i vogël i lojërave të fatit pa numër serik, një shtypës i tiketave “Epson”, me nr.serik TC8Y190597, një shtëpizë kompjuteri HP me nr. serik CZC2106NC2, një monitor me ngjyrë të zezë i markës “Samsung” me numër serik TWZZHYX Q40040712, 40.10 €, si dhe 24 tiketa të lojërave KENO të konfiskohen.

Detyrohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu i akuzuari obligohet që në kuptim të nenit 39, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën PP.II.nr.99/2021, të dt. 26.01.2021, i ka propozuar gjykatës që ndaj të akuzuarit A.A. nga, të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit nga neni 294, parag.2, lidhur me parag.1 të KPRK-së, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Më datë 02.02.2021, Prokuroria e Shtetit ka parashtruar dhe Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë së hartuar nga ana e Prokurorisë së Shtetit - Prokuroria Themelore në Gjilan, në njërën anë dhe të akuzuarit A.A. me mbrojtësin e tij Av. L. C., në anën tjetër.

Në marrëveshjen për pranimin e fajësisë të hartuar ndërmjet palëve, respektivisht Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe të akuzuarit A.A., me mbrojtësin av. L.C., palët kanë përcaktuar kushtet e pranimit të fajësisë, ku ndër të tjera është negociuar dhe propozuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej 160 ditëve, me mundësi që me pëlqimin e të pandehurit e në pajtim me nenin 44 parag.1 dhe 2 të KPRK-së, dënimi me burg t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej 1200,00 €.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë, pas vlerësimit të së njëjtave dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se të njëjtat janë të bazuara në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtave, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të akuzuarit për dat. 03.03.2021, në të cilën seancë gjyqësore, Prokurorja e shtetit Bahtie Ademi, ka deklaruar se mbetet pranë aktakuzës PP.II.nr.99/2021, të dt. 26.01.2021, kundër të akuzuarit A.A., për shkak të veprës penale, Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit nga neni 294, parag.2, lidhur me parag.1 të KPRK-së dhe Marrëveshjen për pranimin e fajësisë të datës 26.01.2021, e lidhur në Prokurorin Themelore në Gjilan-Departamenti i përgjithshëm, nga fakti se i akuzuari në prezencën e mbrojtësit të tij av. L. C., në mënyrë vullnetare pa shtrëngim apo nën presion në tërësi ka pranuar benefitet dhe pasojat e kësaj marrëveshje.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë PP.II.nr.99/2021, është hartuar më datë 26.01.2020, në mënyrë vullnetare nga të pranishmit dhe e pranuar nga i akuzuari A.A., në tërësi si marrëveshje me të gjitha pikat dhe konditat e saj.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.A., respektivisht av.L. C., thekson se mbetet në tërësi pranë marrëveshjes së nënshkruar dhe pranuar nga i akuzuari dhe njëkohësisht i propozuan gjykatës që ta aprovoj në tërësi marrëveshjen me të gjitha elementet - kushtet e saj.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga i akuzuari, respektivisht nga vetë përmbajtja dhe kushtet e pranimit të marrëveshjes së pranimit të fajësisë, ku i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata, sipas detyrës zyrtare e në harmoni me nenin 257 të KPPRK-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa-pranueshme dhe e marrë në kundërshtim me dispozitat e nenit të lartë-theksuar e cila do të vinte në mëdyshje dhe do të bënte të papranueshëm pranimin e fajësisë. Gjithashtu, gjykata konsideroi se nuk ekzistojnë rrethana të përcaktuara nga neni 253 të KPPRK-së të cilat do të konsistonin në krijimin e situatës dhe rrethanave për hedhjen e aktakuzës.

Gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes së pranimit të fajësisë, gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën-pasojat e marrëveshjes për pranimin e fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë. Marrëveshja për pranimin e fajësisë, respektivisht pranimi i fajësisë nga i njëjti është bërë në mënyrë vullnetare, pa kushtëzim, pa presion, askush nuk ia ka bërë ndonjë premtim të kundërligjshëm i cili do të shtyjë në pranimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, heqin dorë nga e drejta në gjykim të rregullt, respektivisht nga të gjitha të drejtat që kanë të bëjnë me gjykimin e rregullt, pas konsultës së mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe në harmoni me dispozitat e neneve 233 dhe 246 e 248 të KPPRK-së.

Ndërsa sa i përket dënimit dhe vendimit për dënimin, Prokurorja e Shtetit Bahtie Ademi, i akuzuari A.A. dhe mbrojtësi i tij av. L. C., propozuan gjykatës që ta aprovoj dënimin e përcaktuar në marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Gjykata duke marrë në konsideratë rrethanat të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, respektivisht rrethanat e përcaktuara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, erdhi në përfundim se dënimi i propozuar nga palët është dënim i cili i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të tij-akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen i akuzuari të jetë më i përgjegjshëm dhe të përmbahet nga veprimet e këtilla.

Gjatë vendosjes për dënimin, gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit, ndërsa si rrethana tejet lehtësuese ka konsideruar: pranimin e fajësisë nga i akuzuari, ku këtë gatishmëri të pranimit të fajësisë i njëjti e ka shprehur që në fazat e hershme hetimore me lidhjen marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Andaj, bazuar në rrethanat e lartë-theksuara gjykata ka aprovuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë në tërësi me të gjitha elementet e saja, respektivisht ka aprovuar dënimin e propozuar nga palët – dënim burgu në kohëzgjatje prej 160 ditëve, i cili dënim në kuptim të nenit 44 parag.1 dhe 2 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit do t'i zëvendësohet në dënim me gjobë, në shumën prej 1.200.00 €, të cilin dënim me gjobë, i pandehuri obligohet që të e paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit në tri këste mujore, në të kundërtën dënimin me gjobë të njëjtit do ti zëvendësohet me dënim burgu ashtu që për çdo 20 €, do ti llogaritet nga një ditë burg.

Andaj bazueshëm mund të pritët që ky dënim do të ndikoj pozitivisht në përmirësimin e të akuzuarit, do të ketë ndikim edukativ edhe ndaj qytetarëve tjerë që në të ardhmen mos të kryejnë vepra penale, sikundër që do t'i kontribuojnë disiplinës dhe përgjegjësisë më të madhe të qytetarëve në përgjithësi.

Të pandehurit në pajtim me nenin 115, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KPPRK-ës, i konfiskohen: Dy çelësa të aparateve për lojëra të fatit, dy aparate të lojërave të fatit të tipit “Mercur” një aparat i vogël i lojërave të fatit pa numër serik, një shtypës i tiketave “Epson”, me nr.serik TC8Y190597, një shtëpizë kompjuteri HP me nr. serik CZC2106NC2, një monitor me ngjyrë të zezë i markës “Samsung” me numër serik TWZZHYX Q40040712, 40.10 €, si dhe 24 tiketa të lojërave KENO të konfiskohen.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues, bazuar në nenin 451 paragrafi 1 i KPPRK-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (Njëzetë euro), si dhe 30 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjilan- Dega në Kamenicë,

P.19/2021, më datë 22.03.2021

Gj y q t a r i,

Sadri Krasniqi,d.v.

Këshilla Juridike : ky aktgjykim është i plotfuqishëm që në datën e shpalljes-publikimit të tij, pasi që palët kanë hequr dorë nga e drejta e ushtrimit të ankesës ndaj të njëjtit.